



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:037569

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428678

E.nr.535/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përbarimit të kreditorëve: Z.B.-H. të cilët i përfaqëson Av. Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e shumës në emër të shpenzimeve të udhëtimit, të ushqimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 08/03/2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën E.nr.535/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.535/23, të datës 22/03/2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Spitali i përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Pajtitimit Gjyqësor: 2020:037569, të datës 24.09.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 12/9/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 10,304.00euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorë.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.535/23, më datë 08.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi